REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E SHËRBIMEVE JURIDIKE DHE INTEGRIMIT
DREJTORIA E SHËRBIMEVE JURIDIKE
SEKTORI I NDIHMËS DHE KOORDINIMIT TË INFORMACIONIT

Nr. 3072 Prot. Tiranë, më 26.10.2026

NJOFTIM ME SHPALLJE
TË VENDIMIT NR. 2318/1 PROT., DATË 02.09.2026 TË INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË, "PËR ARKIVIMIN PAS SHQYRTIMIT FILLESTAR TË ANKESËS, SË PARAQITUR NGA SHTETASJA ZNJ. MIRELA HASANBEGAJ, PËR NJË PJESË TË PRETENDIMEVE TË NGRITURA"

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka marrë në shqyrtim ankesën e paraqitur nga znj. Mirela Hasanbegaj me nr. 2592 prot., datë 23.09.2024, në të cilën ngrihen pretendime ndaj prokurorëve A, H, me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Vlorë në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar disiplinore, si dhe ndaj prokuroreve S.B dhe V. M me detyrë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Sarandë, në kohën e kryerjes së shkeljes së pretenduar disiplinore, dhe me vendimin nr. 2318/1 prot., datë 02.09.2026, "Për arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës së paraqitur nga shtetasja znj. Mirela Hasanbegaj, për një pjesë të pretendimeve të ngritura", bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "d" dhe "dh", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar si dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar, ka vendosur arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesës për një pjesë të pretendimeve. Vendimi duhet t'i njoftohet ankuesit, brenda 5 ditëve nga marrja e tij. Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë të Prokurorisë, brenda 1 jave nga marrja e njoftimit të tij.

Meqenëse nuk është arritur njoftimi i vendimit në adresën e deklaruar nga ankuesi, bazuar në parashikimet e nenit 162 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", Inspektori i Lartë i Drejtësisë, bën njoftimin publik të vendimit, nëpërmjet kësaj shpallje për një afat 10 ditor. Njoftimi publik vlerësohet i kryer pas 10 ditëve nga data e shpalljes.

Njoftimi i vendimit me shpallje publikohet:
- një kopje në këndin e njoftimeve të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë;
- një kopje në këndin e njoftimeve të Bashkisë Sarandë, sipas adresës së lënë nga ankuesi Lagjja Nr.2. Sarandë;
- në faqen zyrtare të internetit të Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë: www.ild.al

Shpalljet që do të afishohen, hartohen në dy kopje me qëllim që një prej tyre të kthehet në Zyrën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me nënshkrimin dhe datën që shpallja u afishua.

SEKRETAR I PËRGJITHSHËM

Dëshira Pasko

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË